


RAPORTI VJETOR

2025



Bursa Shqiptare e Titujve ALSE
www.alse.al

PASQYRA E LËNDËS

RRETH BURSËS SHQIPTARE TË TITUJVE ALSE.....	2
Aksionarët.....	2
Këshilli Mbikëqyrës.....	2
VEPRIMTARIA E BURSËS SHQIPTARE TË TITUJVE ALSE.....	3
Anëtarësimi.....	3
Listimi.....	4
Listimi i Titujve Qeveritar.....	4
Listimi i Titujve Privat.....	4
Analiza e Tregut të Bursës dhe Statistika.....	4
Marrëdhënie Ndëristitucionale dhe Edukimi Financiar.....	8
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE.....	10

RRETH BURSËS SHQIPTARE TË TITUJVE ALSE

Aksionarët



Këshilli Mbikëqyrës



INES MUÇOSTEPA
ANËTARE



Prof. Dr. HYSEN ÇELA
KRYETAR



Prof. Dr. ELVIN MEKA
ANËTAR


VEPRIMTARIA E BURSËS SHQIPTARE TË TITUJVE ALSE

Anëtarësimi

Përgjatë vitit 2025, numri i anëtarëve të Bursës ALSE ka mbetur i pandryshuar. Nga këta, 2 anëtarë janë të regjistruar për dy tregje (tregu i titujve të Qeverisë dhe tregu i titujve të borxhit privat), ndërsa një anëtar tjetër është i regjistruar vetëm për tregun e titujve të Qeverisë.

Për të dy tregjet (tregu i titujve të Qeverisë dhe tregu i titujve të borxhit privat), anëtarët gëzojnë të drejta të plota për të realizuar veprime me titujt, si për llogari të thesarit të tyre, ashtu edhe për llogari të klientëve të tyre.

Anëtar të Bursës ALSE



Banka Credins sh.a:

Në vitin 2018 është anëtarësuar për tregtimin e titujve të Qeverisë.

Në vitin 2023 është anëtarësuar për tregtimin e titujve të borxhit privat.

Ky Anëtar u ofron shërbimin e brokerimit klientëve të tij në Bursë nëpërmjet tre Brokerave.

Banka Amerikane e Investimeve sh.a. :

Në vitin 2018 është anëtarësuar për tregtimin e titujve të Qeverisë.

Në vitin 2023 është anëtarësuar për tregtimin e titujve të borxhit privat.

Ky Anëtar u ofron shërbimin e brokerimit klientëve të tij në Bursë nëpërmjet një Brokери.

Dhe

Intesa Sanpaolo Bank sh.a:

Në vitin 2019 është anëtarësuar për tregtimin e titujve të Qeverisë.

Ky Anëtar u ofron shërbimin e brokerimit klientëve të tij në Bursë nëpërmjet një Brokери.

Listimi

Listimi i Titujve Qeveritar

Titujt e Borxhit Qeveritar, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullativ të Bursës ALSE, listohen në tregun kryesor duke përdorur metodën e tregtimit të vazhdueshëm. Në Bursën ALSE, listohen të gjithë titujt e Borxhit të Qeverisë (Bono dhe Obligacione Thesari) me emetues Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Prej nisjes së aktivitetit të ALSE, janë listuar gjithsej 503 tituj, nga të cilët 205 janë Obligacione Thesari dhe 299 Bono Thesari.

Numri i titujve aktivë për tregtim në Sistemin Elektronik të Tregtimit të ALSE ndryshon vazhdimisht, duke reflektuar në çdo moment listimet e reja si dhe maturimet e titujve

Listimi i Titujve Privat

Në Bursën Shqiptare të Titujve ALSE është regjistruar vetëm një titull privat, i emetuar nga institucioni financiar NOA sh.a. Gjatë vitit 2025, nuk është regjistruar asnjë kërkesë nga kompani për emetim publik.


Analiza e Tregut të Bursës dhe Statistika

Bursa Shqiptare e Titujve ALSE ka filluar aktivitetin e saj në muajin shkurt të vitit 2018. Gjatë gjithë periudhës së funksionimit të saj, Bursa ka vepruar në përputhje me profesionalizmin e kërkuar dhe me kuadrin ligjor në fuqi, duke garantuar në çdo moment mbrojtjen e interesave të investitorëve.

Në një analizë të përgjithshme, gjatë vitit 2025, vlera e transaksioneve të realizuara dhe të raportuara në Bursën Shqiptare të Titujve ALSE arriti në 796.2 milionë lekë, ose rreth 8.23 milionë euro, me një volum prej 10,743 njësi titujsh të tregtuar dhe gjithsej 112 transaksione të realizuara.


Përmes një analize më të thelluar të transaksioneve të ekzekutuara dhe të raportuara gjatë këtij viti, vihet re se ato janë karakterizuar nga

- Transaksionet për Klientët;




Transaksionet për llogari të klientëve kanë dominuar në të tri indikatorët kryesorë të analizës, si në numrin e tregtimeve, volumin e tregtuar, ashtu edhe në vlerën totale të transaksioneve.

Transaksionet jashtë Orareve Zyrtare (Off-Exchange);



Viti 2025 është shoqëruar me një numër dominues transaksionesh të realizuara jashtë orareve zyrtare të Bursës, të cilat përbëjnë 93.8 % të totalit të transaksioneve të raportuara. Ky trend mbizotërues pasqyrohet gjithashtu në vlerën totale të tregtuar dhe volumin e tregtuar.

Transaksionet në Obligacione Thesari;



Transaksionet në Obligacionet e Thesarit gjatë vitit 2025 kanë dominuar krahasuar me Bonot e Thesarit dhe Obligacionet Private, një tendencë që lidhet kryesisht me maturimin e këtyre titujve. Nga ana tjetër, Bonot e Thesarit mbahen kryesisht nga investitorët deri në maturim. Sa i përket Obligacionit Privat të listuar në Bursë, ky i fundit është vetëm një titull i vetëm i listuar, çka reflekton edhe numrin e ulët të transaksioneve.

Transaksionet e ekzekutuara gjatë orareve zyrtare të Bursë ALSE

Gjatë vitit 2025, janë ekzekutuar 7 (shtatë) transaksione gjatë orareve zyrtare të Bursës, me një vlerë totale prej 89.06 milionë lekë dhe 856 njësi (volum) titujsh të tregtuar.

Transaksionet për llogari të klientëve kanë dominuar në vlerën e tregtimit (100%) dhe në numrin e transaksioneve të realizuara (100%), dhe në volum (100%).

Tabela 1: Të dhënat e tregtimeve gjatë orareve zyrtare sipas llojit të llogarive

Lloji i llogarive	Nr. Tregtimi	Volum i Tregtuar	Vlera e Tregtuar
Ndërbankare	0	0	0
për Klientët	7	856	89,064,500

*Volumi i tregtuar është i shprehur në njësi Titujsh

Instrumentat e tregtuar gjatë orareve zyrtare kanë qenë të nominuar në lekë.

Transaksionet e ekzekutuara jashtë orareve zyrtare të Bursës ALSE

Gjatë vitit 2025 janë ekzekutuar 105 transaksione jashtë orareve zyrtare, me një vlerë prej 707.15 milion Lekë dhe 9,887 njësi (volum) titujsh të tregtuar.

- Sipas Llojit të Llogarisë

Pjesa më e madhe e transaksioneve të realizuara jashtë orareve zyrtare ka qenë e orientuar në tregun me pakicë, më konkretisht transaksione bankë-klient ose klient-klient, krahasuar me transaksionet ndërbankare. Transaksionet për llogari të klientëve të realizuara jashtë bursës kanë dominuar në vlerën totale të tregut (100% e totalit), në volum (100% e totalit të njësi titujsh të tregtuar) dhe në numrin e transaksioneve të realizuara (100% e totalit).

Tabela 2: Të dhënat e tregtimeve të ekzekutuara jashtë orareve zyrtare sipas llojit të llogarisë

Lloji i Llogarisë	Nr. Tregtimi	Volum i Tregtuar	Vlera e Tregtuar
Ndërbankare	0	0	0
për Klientët	105	9,887	707,154,414

*Volumi i tregtuar është i shprehur në njësi Titujsh

- Sipas Llojit të Instrumentit (titullit) që tregtohet

Pjesa më e madhe e transaksioneve të realizuara jashtë orarit zyrtar të Bursës ka përfshirë Obligacione Thesari, krahasuar me transaksionet në Bono Thesari. Transaksionet e raportuara në Obligacione Thesari kanë mbizotëruar në vlerën e tregtuar (95% e totalit), në numrin e transaksioneve (86% e totalit) dhe në volumin e tregtuar (64% e totalit).


Tabela 3: Te dhënat e tregtimeve të ekzekutuara jashtë orareve zyrtare sipas llojit të titulli

Lloji i Titullit	Nr. Tregtimi	Volum i Tregtuar	Vlera e Tregtuar
Bono Thesari	15	3,599	35,389,934
Obligacione Thesari	90	6,288	671,764,480
Obligacione Private	0	0	0

*Volumi i tregtuar është i shprehur në njësi Titujsh


Bonot e Thesarit

Gjatë vitit 2025, sic vihet re dhe në grafikët më poshtë, janë raportuar në Bursë vetëm transaksione në Bono Thesari me afat maturimi 12 mujor ndërkohë për afatet e tjera nuk ka patur transaksione të raportuara.



Obligacionet e Thesarit

Parë në këndvështrimin e maturimit të Obligacioneve të Thesarit, titujt më aktivë të tregtuar jashtë orarit zyrtar janë ato me maturim 10 vjeçar, ndjekur nga 15 dhe 7 vjeçarët.



Marrëdhënie Ndëristitucionale dhe Edukimi Financiar

- **Nënshkrimi i kontratës së bashkëpunimit me Bankën Credins**

Si pjesë e angazhimeve të saj për edukimin financiar dhe zhvillimin e tregjeve të kapitalit, Bursa ALSE ka nënshkruar për të tretin vit rradhazi një kontratë të rëndësishme me Bankën Credins, e cila ka për qëllim ofrimin e trajnimeve dhe mbështetje për forcimin e aftësive profesionale të stafit të bankës. Ky program trajnimi është orientuar në promovimin dhe shpjegimin e shërbimeve të investimit që Banka Credins ofron, për të cilat është e licencuar nga autoritetet përkatëse. Ky bashkëpunim ka për qëllim rritjen e kapaciteteve të stafit të bankës në ofrimin e informacionit të saktë dhe të kuptueshëm për klientët, duke kontribuar kështu në zhvillimin e mëtejshëm të tregut të kapitalit në Shqipëri. Menjëherë pas nënshkrimit të kësaj kontrate, janë zhvilluar disa trajnime intensive dhe profesionale për stafin e shitjes të Bankës Credins, ku janë trajtuar aspekte kyçe të investimeve dhe produkteve financiare, me fokus të veçantë në mundësitë e investimeve në tregjet e titujve të borxhit dhe instrumenteve të tjera financiare.

- **Zhvillimi i trajnimeve me studentët pjesëmarrës në programin “YouAreCredins”**

Bursa ALSE ka ofruar trajnime për të disatën vit radhazi studentët pjesëmarrës në programin YouAreCredins, një iniciativë e rëndësishme e Bankës Credins, e cila ka për qëllim rekrutimin dhe përgatitjen e studentëve për t’u bërë pjesë e stafit të saj. Ky program ka ofruar mundësinë që një numër i konsiderueshëm studentësh të njohin më thellë jo vetëm konceptet bazë të tregut të kapitalit, por edhe strukturën dhe mënyrën e funksionimit të Bursës ALSE, një aktor kyç në zhvillimin e tregjeve të kapitalit në Shqipëri.

Nëpërmjet këtyre trajnimeve, studentët janë njohur me temat kyçe si tregtimi i titujve të borxhit, instrumentet financiare të disponueshme për investim dhe rregulloret që drejtojnë aktivitetet në bursë. Ata janë informuar gjithashtu mbi proceset e listimit të instrumenteve financiare, si dhe mbi rolin e Bursës në mbikëqyrjen e transparencës dhe sigurimit të kushteve të drejtë për zhvillimin e tregut.

Programi ka pasur një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve, duke i pajisur ata me njohuri dhe praktika të domosdoshme për karrierën e mundshme në sektorin financiar dhe tregjet e kapitalit. Gjithashtu, ky bashkëpunim ka ofruar mundësinë që studentët të kuptojnë rëndësinë e tregjeve të kapitalit në ekonominë kombëtare dhe të shohin mundësitë e zhvillimit të karrierës në këtë fushë, duke kontribuar në rritjen e numrit të profesionistëve të kualifikuar në këtë sektor.

BURSA SHQIPTARE E TITUJVE ALSE SH.A.
Pasqyrat Financiare më dhe
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025
(së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur)

PËRMBAJTJA

	Faqe
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	i-iii
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBYES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	6
PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE	7
SHËNIMET PËR PASQYRAT FINANCIARE	8-33

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar: Aksionerëve të Shoqërisë "Bursa Shqiptare e Titujve "ALSE" sh.a

Raport mbi auditimin e pasqyrave financiare

Opinionin

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë "Bursa Shqiptare e Titujve "ALSE" sh.a. (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar në datën 31 dhjetor 2025, pasqyrën e fitim ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2025, performancën e saj financiare dhe rrjedhën e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Tërheqje vëmendje

Ne tërheqim vëmendjen për shënimin 5.1 "Parimi i vijimësisë" të pasqyrave financiare, duke theksuar se Shoqëria ka raportuar humbje gjatë periudhës që mbyllet më 31 dhjetor 2025 dhe vështirësi financiare, të cilat mund të ndikojnë në aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Pasqyrat financiare janë përgatitur duke supozuar se shoqëria do të vazhdojë aktivitetin e saj në të ardhmen. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Të dhëna të tjera

Drejtimi është përgjegjës për të dhëna të tjera. Të dhënat e tjera konsistojnë në të dhëna të përfshira në raportin vjetor, përgatitur nga Drejtimi, në përputhje me Nenin 17 dhe 19 të Ligjit nr. 25/2018 "Të kontabilitetit dhe pasqyrave financiare", i ndryshuar, por nuk përfshin Pasqyrat Financiare dhe Raportin tonë të Auditimit. Raporti vjetor pritet të jetë i disponueshëm për ne, pas datës së këtij Raporti të Audituesit të Pavarur. Opinioni jonë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon të dhëna të tjera dhe ne nuk shprehim asnjë formë opinioni mbi to.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë të dhënat e tjera të identifikuara më lart, kur këto të dhëna të jenë të disponueshme dhe, duke e bërë këtë, të konsiderojmë nëse informacioni tjetër nuk është material në kundërshtim me pasqyrat financiare apo njohuritë tona të marra gjatë auditimit, ose në të kundërt nëse është material. Gjatë rishikimit të raportit vjetor, nëse konstatojmë se ekziston një gabim material në të, nga ne kërkohet që t'ua komunikojmë çështjen drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne, gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.

- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Kreston Albania Sh.p.k.

Rruga Muhamet Gjollësja, shk. B, K. 6, Ap. B-6

Pranë Qendrës Tregtare Ring Tirane Shqipëri, 1001

Numri I Identifikimit të Personit të Tatueshëm L420070121

Rezar Llukaçej

Auditues Ligjor

Partner Angazhimi

Tiranë më, 8 prill 2026



Bursa Shqiptare e Titujve ALSE sh.a.

Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat janë të shprehura në lekë përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
AKTIVET			
Aktivet Afatshkurtra			
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	7	78,495	83,256
Kerkesa te arketueshme dhe te tjera te arketueshme	8	178,500	287,497
Parapagime dhe shpenzime te shtyra	9	19,967	19,967
Totali i Aktiveve Afatshkurtra		276,962	390,720
Aktivet Afatgjata			
Aktivet afatgjata materiale	10	420,047	589,043
E drejta e perdorimit te aseteve IFRS 16	10	-	-
Aktivet afatgjata jomateriale	11	2,497,649	3,711,413
Totali i Aktiveve Afatgjata		2,917,696	4,300,456
Totali i Aktiveve		3,194,658	4,691,176
DETYRIMET DHE KAPITALI			
Detyrimet Afatshkurtra			
Detyrimet per t'u paguar dhe parapagime	12	213,999	337,089
Te ardhura te shtyra	13	-	-
Detyrimi afatshkurter IFRS 16	14	-	-
Totali i Detyrimeve Afatshkurtra		213,999	337,089
Detyrimet Afatgjata			
Detyrim tatim i shtyre	15	221,913	327,611
Detyrime të qirasë	14	-	-
Totali i Detyrimeve Afatgjata		221,913	327,611
Totali i Detyrimeve		435,911	664,700
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar	16	85,000,000	85,000,000
Humbja e mbartur		(80,973,525)	(79,544,259)
Humbja e periudhës		(1,267,730)	(1,429,266)
Totali i Kapitalit		2,758,746	4,026,475
Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit		3,194,657	4,691,176

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8-33 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga Bursa Shqiptare e Titujve ALSE sh.a më 8 prill 2026 dhe firmosur për llogari të tyre :

Erinda Fiku
Erinda Fiku
Administrator



Dall Kazazi
Kazazi Consulting Shpk
Hartues i pasqyrave financiare



Bursa Shqiptare e Titujve ALSE sh.a.

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat janë të shprehura në lekë përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
Të ardhurat			
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	17	2,364,819	2,880,083
Të ardhura të tjera	17	2,509,974	3,511,084
Totali i të ardhurave		4,874,793	6,391,167
Shpenzimet			
Kosto e punes:	18	(1,147,040)	(2,761,095)
Pagat e personelit	18	(960,000)	(2,313,482)
Sigurime shoqerore dhe shendetesore	18	(187,040)	(447,613)
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale IFRS 16	10	(168,996)	(222,180)
Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale	11	(1,213,764)	(1,232,892)
Shpenzime administrative	19	(3,646,287)	(3,626,933)
Totali i shpenzimeve		(6,176,087)	(7,843,100)
Humbja nga veprimtaritë kryesore		(1,301,295)	(1,451,933)
Shpenzime financiare, neto	20	(61,873)	(74,439)
Fitim nga kursi i këmbimit	21	(10,260)	(11,460)
Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare		(72,133)	(85,899)
Humbja para tatimit		(1,373,428)	(1,537,832)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	15	105,698	108,566
Humbja neto e vitit financiar		(1,267,730)	(1,429,266)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Total i humbjeve gjithëpërfshirëse të vitit		(1,267,730)	(1,429,266)

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8-33 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Bursa Shqiptare e Titujve ALSE sh.a.

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat janë të shprehura në lekë përveçse kur përcaktohet ndryshe)

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
Humbja neto e vitit financiar	(1,267,730)	(1,429,266)
Fitimi per:		
Pronarët e njësisë ekonomike mëmë	-	-
Interesat jo-kontrolluese	-	-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	(1,267,730)	(1,429,266)

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8-33 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Bursa Shqiptare e Titujve ALSE sh.a.

Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat janë të shprehura në lekë përveçse kur përcaktohet ndryshe)

Pozicioni me 31 dhjetor 2023	Kapitali i nënshkruar	Humbje të akumuluar	Humbja e periudhës	Totali
Kontribut në kapital	-	-	-	-
Kalim në humbje të akumuluar	-	(5,750,113)	5,750,113	-
Humbja e periudhës	-	-	(1,429,266)	(1,429,266)
Pozicioni me 31 dhjetor 2024	85,000,000	(79,544,260)	(1,429,266)	4,026,474
Kontribut në kapital	-	-	-	-
Kalim në humbje të akumuluar	-	(1,429,266)	1,429,266	-
Humbja e periudhës	-	-	(1,267,730)	(1,267,730)
Pozicioni me 31 dhjetor 2025	85,000,000	(80,973,526)	(1,267,730)	2,758,745

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8-33 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Bursa Shqiptare e Titujve ALSE sh.a.

Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2025

(Të gjitha shumat janë të shprehura në lekë përveçse kur përcaktohet ndryshe)

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
Flukse monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit		
Fitim (humbje) para tatimit		
Rregullime per:	(1,373,428)	(1,537,832)
Amortizimin e aktiveve afatgjata materiale	10 169,001	222,185
Amortizimin e aktiveve afatgjata jomateriale	11 1,213,764	1,232,892
(Rritje) ulje ne kerkesa te arketueshme dhe te tjera te arketueshme	8 108,997	168,760
(Rritje) ulje ne parapagime dhe shpenzime te shtyra	9 (0)	44,768
Rritje (ulje) ne detyrimet per t'u paguar dhe parapagime	12 (123,091)	(4,065,040)
Rritje ne te ardhura te marra ne avance	-	-
Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytëzimit	(4,756)	(3,934,266)
Interes i paguar	19 -	-
Interes i arkëtuar	19 -	-
Fluksi monetar neto nga veprimtarite e shfrytëzimit	(4,756)	(3,934,266)
Flukset monetare nga aktiviteti investues		
Investime në depozita me afat	-	-
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	10 -	-
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata jomateriale	11 -	-
Mjete Monetare të përdorura në aktivitetin e investimit	-	-
Flukset monetare nga aktivitetet financuese		
Huamarrje afatshkurtër	-	-
Kontribute në kapital	17 -	-
Mjete Monetare të gjeneruara nga aktivitetet financuese	-	-
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(4,756)	(3,934,266)
Mjetet Monetare në fillim	83,256	4,017,522
Mjetet Monetare në fund të vitit	78,499	83,256

Pasqyra e pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8-33 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

1. TË PËRGJITHSHME

Shoqëria "Bursa Shqiptar e Titujve ALSE" sh.a. (më poshtë referuar si "Shoqëria") është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit më datë 24 korrik 2017 dhe prane Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë me NIPT L71928011S. Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet në përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit 9901, datë 14 prill 2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", nga akti i themelimit dhe statuti i saj si dhe nga Ligji Nr. 62/2020 "Për Tregjet e Kapitalit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij".

"Bursa Shqiptare e Titujve ALSE" sh.a. është themeluar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe liçensuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në datë 03.07.2017, me Licencë Nr. 02, për të operuar si treg i organizuar i listimit dhe tregtimit të Titujve, në përputhje me Ligjin 9879 datë 21.02.2008 "Për Titujt" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.62/2020, "Për Tregjet e Kapitalit" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ALSE mori të gjitha masat për të siguruar përshtatjen e aktivitetit të saj me kërkesat e reja ligjore. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me Vendimin e Bordit nr.90, datë 28.04.2022, miratoi përshtatshmërinë e shoqërisë për ushtrimin e veprimtarisë së bursës në përputhje me kërkesat e Ligjit 62/2020 "Për Tregjet e Kapitalit" si dhe e pajisi Bursën Shqiptare të Titujve me Licencën e re të aktivitetit.

Shoqëria zotërohet nga aksionarët Banka Credins, Banka Amerikane e Investimeve dhe AK-Invest, të cilët më 31 dhjetor 2025 zotërojnë respektivisht 45,59%, 45,59% dhe 8.82% të kapitalit themeltar.

Administrator i Shoqërisë është Znj. Erinda Fiku. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë më 31 dhjetor 2025 janë:

1. Hysen Çela
2. Ines Muçostepa
3. Elvin Meka

Selia kryesore e Shoqërisë ndodhet në Rrugën "Nikolla Tupe", Nr.1, Kati 4, Ap.4, Tiranë. Numri i punonjësve të Shoqërisë më 31 dhjetor 2025 është 3 (2024:4).

2. BAZAT E PËRGATITJES

2.1 Deklarata e përputhshmerisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me kërkesat e raportimit financiar dhe legjislacionit në Shqipëri. Kuadri kontabël i aplikuar është i bazuar në politikat kontabël të listuara në shënimin 4, të cilat janë të bazuara në kërkesat për raportim sipas Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), të publikuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit ("BNSK"). Më poshtë paraqiten politikat kontabël kryesore të aplikuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

Detaje për politikat kontabël të Shoqërisë, janë përfshirë në Shënimin 4.

2.2 Bazat e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në monedhën shqiptare "Lekë", e cila është monedha funksionale si rrjedhojë e mjedisit ekonomik ku operon shoqëria, dhe të gjitha vlerat janë rrumbullakosur në Lekë, përveç aty ku shprehet ndryshe.

2. BAZAT E PËRGATITJES (vazhdim)

2.4 Parimi i Vijimesise

Shoqëria ka përgatitur pasqyrat financiare në bazë të parimit të vijimesisë që do të thotë se Shoqëria do të vijojë aktivitetin e saj për të ardhmen e parashikueshme edhe pse ky është viti i 9 qe shoqëria operon me rezultat negativ, aksionarët kryesorë të saj do të mbështesin veprimtarinë për të paktën 12 muaj pas datës së raportimit.

Pasiguritë në lidhje me parimin e vijimesisë janë shtruar në shënimin 5.

3. STANDARDE EFEKTIVE PER VITIN DHE STANDARDE TE PUBLIKUARA QE HYJNE NE FUQI

3.1 Standardet e reja dhe të rishikuara efektive për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

Politikat kontabël të miratuara janë në përputhje me ato të vitit financiar të mëparshëm, me përjashtim të politikave të mëposhtme të cilat janë adoptuar nga Shoqëria më 1 janar 2025.

Standardet dhe interpretimet e emetuara, por që nuk kanë hyrë ende në fuqi, deri në datën e deklarimit të pasqyrave financiare të Shoqërisë, janë pasqyruar më poshtë. Shoqëria synon të adoptojë këto standarde, nëse janë të aplikueshme, kur ato të bëhen efektive.

- SNK 1 - Paraqitja e Pasqyrave Financiare – (Ndryshimet në SNK 1);
Amendamenti sqaron se si kushtet me të cilat një njësi ekonomike duhet të përmbushë brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës raportuese ndikojnë në klasifikimin e një pasivi.
- SNRF 16 – Qiratë në shitje dhe kthim nga qiratë (Amendamenti i SNRF 16);
Këto ndryshime përfshijnë kërkesat për transaksionet e shitjes dhe të kthimit nga qiratë në SNRF 16 për të shpjeguar se si një njësi ekonomike llogarit një shitje dhe kthim nga qira pas datës së transaksionit. Transaksionet e shitjes dhe kthimit me qira ku disa ose të gjitha pagesat e qirasë janë pagesa të ndryshueshme të qirasë që nuk varen nga një indeks ose normë kanë më shumë gjasa të ndikohen.
- SNK 7 dhe SNRF 7 – Financat nga furnizuesit (Ndryshimi i SNK 7 dhe SNRF 7);
Këto ndryshime kërkojnë dhënie informacionesh shpjeguese për të rritur transparencën e marrëveshjeve financiare të furnizuesit dhe efektet e tyre në detyrimet, flukset monetare dhe ekspozimin ndaj rrezikut të likuiditetit të një njësie ekonomike. Kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese janë përgjigja e BSNK-së shqetësimeve të investitorëve të marrëveshjeve financiare të disa kompanive me furnizues nuk janë mjaftueshëm të dukshme, duke penguar analizën e investitorëve.
- SNK 21 – Efektet e Ndryshimeve në Kursin e Këmbimit Valutor (Amendimet në SNK 21)
Ndryshimet e mësipërme nuk kanë ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

3.2 Standarde dhe interpretime të publikuara që nuk janë ende të aplikueshme

Standardet dhe interpretimet e emetuara, por që nuk kanë hyrë ende në fuqi, deri në datën e deklarimit të pasqyrave financiare të Shoqërisë, janë pasqyruar më poshtë. Shoqëria synon të adoptojë këto standarde, nëse janë të aplikueshme, kur ato të bëhen efektive. Ndryshimet e mëposhtme janë në fuqi për periudhën që fillon me 1 janar 2026 apo me vonë:

- Amendimi për Klasifikimin dhe Matjen e Instrumenteve Financiare, të cilat sjellin ndryshime në SNRF 9 – Instrumentet Financiare dhe SNRF 7 – Instrumentet Financiare. Këto ndryshime sqarojnë rrethanat në të cilat një detyrim financiar i shlyer përmes një sistemi elektronik pagese konsiderohet i shuar para datës së shlyerjes, si dhe mënyrën e vlerësimit të karakteristikave të flukseve kontraktuale të mjeteve financiare me elementë të kushtëzuar, kur natyra e ngjarjes së kushtëzuar nuk lidhet drejtpërdrejt me rreziqet dhe kostot bazë të huadhënies. Ndryshimet janë në fuqi për periudhën që fillon me 1 janar 2026:

3. STANDARDE EFEKTIVE PER VITIN DHE STANDARDE TE PUBLIKUARA QE HYJNE NE FUQI (VAZHDIM)

3.2 Standarde dhe interpretime të publikuara që nuk janë ende të aplikueshme (vazhdim)

▪ SNRF 18 – Paraqitja dhe Zbulimet në Pasqyrat Financiare

SNRF 18 zëvendëson SNK 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare", duke ruajtur shumicën e kërkesave ekzistuese dhe duke i plotësuar ato me kërkesa të reja. Gjithashtu, disa paragrafë të SNK 1 janë transferuar në SNK 8 "Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet" dhe SNRF 7 "Instrumentet Financiare: Zbulimet". Për më tepër, janë bërë amendime të vogla në SNK 7 "Pasqyra e Rrjedhave të Parasë" dhe SNK 33 "Fitimi për Aksion". SNRF 18 prezanton kërkesa të reja për:

- Paraqitjen e kategorive të përcaktuara dhe nëntotaleve në pasqyrën e fitimit ose humbjes;
- Zbulimet mbi masat e performancës së përcaktuara nga menaxhmenti (MPM) në shënimet shpjeguese;
- Përmirësimin e agregimit dhe ndarjes së informacionit.

Amendimet në SNK 7 dhe SNK 33, si dhe SNK 8 dhe SNRF 7 të rishikuara, hyjnë në fuqi kur njësi ekonomike zbaton SNRF 18. Ky standard kërkon aplikim retrospektiv me dispozita specifike të tranzicionit. Drejtuesit e kompanisë parashikojnë që zbatimi i tij mund të ketë ndikim në pasqyrat financiare të konsoliduara të grupit në periudhat e ardhshme.

▪ SNRF 19 – Filialet pa Përgjegjësi Publike: Zbulimet

SNRF 19 u mundëson filialeve të pranueshme të ofrojnë zbulime të reduktuara duke zbatuar Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) në pasqyrat e tyre financiare. Një filial kualifikohet për këtë regjim nëse nuk ka përgjegjësi publike dhe nëse kompania mëmë ose ndonjë kompani ndërmjetëse publikon pasqyra financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF. Ky standard është opsional dhe përcakton kërkesat e zbulimit për filialet që zgjedhin ta zbatojnë atë. Një filial konsiderohet me përgjegjësi publike nëse instrumentet e tij të borxhit ose kapitalit tregtohen në një treg publik ose është në procesin e emetimit të tyre ose nëse administron pasuri në një kapacitet fiduciar për një grup të gjerë palësh të jashtme, si bankat apo fondet e investimeve. Filialet e pranueshme mund ta zbatojnë SNRF 19 në pasqyrat e tyre financiare të konsoliduara, të ndara ose individuale. Një kompani ndërmjetëse që nuk e aplikon këtë standard në pasqyrat e saj të konsoliduara mund ta zbatojë atë në pasqyrat e veta të veçanta. Nëse një filial zbaton SNRF 19 përpara SNRF 18, ai duhet të ndjekë një grup të modifikuar kërkesash për zbulim. Gjithashtu, filialet që e zbatojnë atë përpara amendimeve në SNK 21 janë të përjashtuara nga kërkesat për zbulim në lidhje me Mungesën e Shkëmbyeshmërisë. Drejtuesit e kompanisë nuk presin që SNRF 19 të zbatohet në pasqyrat financiare të konsoliduara të grupit.

▪ Amendimet në SNRF 9 dhe SNRF 7 – Klasifikimi dhe Matja e Instrumenteve Financiare

Amendimet e publikuara nga BSNK në maj 2024 vijnë si rezultat i rishikimit pas implementimit të kërkesave të klasifikimit dhe matjes të SNRF 9. Amendimet në SNRF 9 sqarojnë çregjistrimin e detyrimeve financiare të shlyera përmes transferimeve elektronike, duke lejuar njësitë ekonomike të konsiderojnë një detyrim të shuar përpara datës së shlyerjes nëse plotësohen kritere të caktuara. Ato gjithashtu përmirësojnë udhëzimet për vlerësimin e përputhshmërisë së flukseve kontraktuale me një marrëveshje të zakonshme huadhënieje, përforcojnë definicionin e veçorive "jo-recourse" dhe sqarojnë karakteristikat e instrumenteve të lidhura kontraktualisht. Amendimet në SNRF 7 sjellin kërkesa të reja për zbulimin e investimeve në kapital të përcaktuara në vlerën e drejtë përmes rezultateve të tjera të gjithanshme (FVTOCI) dhe termave kontraktuale që mund të ndikojnë në kohën ose shumën e flukseve të parasë. Këto amendime hyjnë në fuqi më 1 janar 2026, me mundësinë e aplikimit të hershëm. Njësitë ekonomike duhet t'i zbatojnë ato në mënyrë retrospektive dhe ato mund të kenë ndikim në pasqyrat financiare të konsoliduara në të ardhmen.

Kompania nuk pret që ndonjë standard tjetër i nxjerrë nga BSNK, por ende jo në fuqi, të ketë një ndikim material në pasqyrat financiare të kompanisë.

(Të gjitha shumat janë të shprehura në lekë përveçse kur përcaktohet ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL

Politikat kryesore kontabël të përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare janë të prezantuara më poshtë. Keto politika janë aplikuar në mënyrë konsistente nga Shoqëria gjatë gjithë periudhës së prezantuar në këto pasqyra financiare.

4.1 Transaksionet në monedhë të huaj

a) Monedha prezantuese dhe funksionale

Monedha funksionale është monedha e mjedisit kryesor ekonomik ku Shoqëria vepron. Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lekë Shqiptar, që është monedha funksionale dhe e prezantimit së Shoqërisë.

b) Transaksionet dhe balancat në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat nga këmbimi njihen si fitim apo humbje në pasqyrën përmbledhëse e të ardhurave në periudhën në të cilën ndodhin.

Në fund të çdo periudhe raportuese, mjetet monetare në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin e datës së raportimit. Mjetet jo monetare që mbahen me vlerë të drejtë rregjistrohen në monedhë të huaj dhe rivlerësohen në kursin e datës kur përcaktohet vlera e drejtë. Mjetet jo monetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj nuk rivlerësohen.

Kurset e këmbimit të përdorura për përgatitjen e pasqyrave financiare për monedhat kryesore si në më 31 Dhjetor 2025 janë si vijon:

Kurset e këmbimit zyrtare bankare të zbatuara sipas Bankës së Shqipërisë (Lekë kundrejt njësisë së monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024 ishin si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
EUR	96.77	98.15
USD	82.46	94.26

4.2 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të parave të marra ose të arkëtueshmeve nga shoqëria për mallrat e dhëna, duke përfshirë taksat e shitjes, rabatet, dhe uljet tregtare. Shoqëria aplikon kriteret e njohjes së të ardhurave të përcaktuara si më poshtë tek çdo komponent i veçantë i transaksionit të shitjes në mënyrë që të reflektoje thelbin e transaksionit.

- 1- Identifikimi i kontratës me nje klient
- 2- Identifikimi i kushteve të veçanta të një performace në një kontratë
- 3- Përcaktimi i çmimit të transaksionit
- 4- Shpërndarja e çmimit të transaksionit sipas kushteve të performacës në kontratë
- 5- Njohja e të ardhurave kur një kusht performace është plotësuar.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

4.2 Njohja e të ardhurave (vazhdim)

Të ardhurat e marra nga këto transaksione janë alokuar tek komponentët e veçantë të identifikuar duke patur parasysh vlerën relative të drejtë të çdo komponenti.

Të ardhurat njihen ose në një moment ne kohe ose gjate kohës, kur (ose si) shoqëria përmbush detyrimet e performancës duke transferuar mallrat ose shërbimet e premtuara te klientët e tij.

Shoqëria njih detyrime kontraktuale për shumat e arkëtuara në lidhje me detyrimet e performancës të papërmbushura dhe raporton shumat tilla si detyrime të tjera në pasqyrën e pozicionit të pozicionit financiar. Në mënyrë të ngjashme, nëse Shoqëria përmbush një detyrim të performancës përpara se të arkëtojë, Shoqëria njih ose një aktiv të kontratës ose një të arkëtueshme në pasqyrën e tij të pozicionit financiar, në varësi të faktit nëse kërkohet diçka tjetër përveç kohës së kalimit para se të bëhet pagesa.

4.3 Aktive afatgjata jomateriale

Aktivet afatgjata jo-materiale të blera nga Shoqëria janë paraqitur me kosto të pakësuar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar të rënies në vlerë. Shpenzimet vijuese të aktiveve afatgjata të patrupëzuara kapitalizohen vetëm kur rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike nga aktivet specifike me të cilat lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera shpenzohen në momentin që ndodhin.

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, bazuar në metodat dhe ne normat e paraqitura si me poshte:

	Metoda	2025	2024
Programe kompjuterike	Lineare	10%	10%

Jetëgjatësia e aktiveve afatgjata jomateriale është vlerësuar për 10 vite.

4.4 Aktive afatgjata materiale

i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë paraqitur me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivitetit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrë të synuar nga drejtimi. Blerja e programeve që janë të lidhur ngushtë me funksionalitetet e pajisjes përkatëse janë kapitalizuar si një pjesë e kësaj pajisje. Kur pjesët e një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elementë të veçantë (komponentet kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

ii) Kosto të mëtejshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në Shoqëri dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin kur ndodhin.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

4.4 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iii) Amortizimi/Zhvlerësimi

Amortizimi njihet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave me metodën e vlerës së mbetur. Aktivet me qira zhvlerësohen për më të voglën mes periudhës së qirasë dhe jetëgjatësisë së dobishme.

Norma e amortizimit vjetor është si me poshtë:

	2025	2024
Rikonstrukcion dhe Ndertesa	5%	5%
Mobilje dhe pajisje zyre	20%	20%
Pajisje informatike	25%	25%

Toka dhe ndërtimi në proçes nuk amortizohen. Metodatat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe rregullohen nëse është e përshtatshme. Vlera kontabël e një aktivi shpenzohet menjëherë deri në shumën e rikuperueshme, nëse vlera kontabël e aktivitetit është më e madhe se shumata e vlerësuar e rikuperueshme.

Fitimet dhe humbjet që vijnë nga zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale përcaktohen si diferencë midis të ardhurave nga shitja dhe vlerës kontabël të aktivitetit dhe njihet në fitim ose humbje të periudhës financiare.

4.5 Të drejtat e përdorimit të aktiveve

Shoqëria si qiramarrëse për çdo kontratë të re të lidhur me ose pas 01 janar 2019, konsideron nëse është një kontratë, apo përmban një qira. Një qira përcaktohet si "një kontratë, ose pjesë e një kontrate, që përcjell të drejtën për të përdorur një aktiv (aktivin themelor) për një periudhë kohe në këmbim të pagesës".

SNRF 16, Qiratë (publikuar më 13 janar 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019), përcakton parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe shënimet shpjeguese të qirasë. Të gjitha qiratë rezultojnë që qiramarrësi merr të drejtën e përdorimit të një aktivi në fillim të periudhës së qirasë dhe nëse pagesat e qirasë bëhen përgjatë kohës, gjithashtu merr financim. Rrjedhimisht, SNRF 16 eliminon klasifikimin e qirave si qira operative ose qira financiare siç kërkohej nga SNK 17 dhe, në vend të kësaj, prezanton një model të vetëm të kontabilizimeve nga qiramarrësit.

Për të zbatuar këtë përkufizim, shoqëria vlerëson nëse kontrata përmbush tre vlerësime kryesore, të cilat janë:

- Kontrata përmban një aktiv të identifikuar, i cili ose përcaktohet në mënyrë të qartë në kontratë ose specifikohet në mënyrë të qartë duke u identifikuar në kohën kur aktivi është vënë në dispozicion të shoqërisë
- Shoqëria ka të drejtë të sigurojë në tërësi të gjitha përfitimet ekonomike nga përdorimi i aktivitetit të identifikuar gjatë gjithë periudhës së përdorimit, duke marrë parasysh të drejtat e tij në qëllimin e caktuar të kontratës
- Shoqëria ka të drejtë të përcaktojë përdorimin e aktivitetit të identifikuar gjatë gjithë periudhës së përdorimit. Shoqëria vlerëson nëse ka të drejtë të përcaktojë 'si dhe për çfarë qëllimi' aktivi përdoret gjatë gjithë periudhës së përdorimit.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

4.5 Të drejtat e përdorimit të aktiveve(vazhdim)

Matja fillestare

Matja fillestare e aktivitetit me të drejtë përdorimi

Në datën e fillimit, Shoqëria në rolin e qiramarrësit mat aktivitetin me të drejtë përdorimi me kosto. Kosto e aktivitetit me të drejtë përdorimi do të përfshijë;

- a) shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë sic përshkruhet më poshtë;
- b) çdo pagesë të qirasë të bërë para ose në datën e fillimit minus çdo stimul qiraje të marre;
- c) çdo kosto fillestare të drejtëpërdrejtë të kryer nga qiramarrësi; dhe
- d) dhe një vlerësim të kostove që do të ndodhin nga qiramarrësi për cmontimin dhe lëvizjen e aktivitetit bazë.

Matja fillestare e detyrimit të qirasë

Në datën e fillimit, Shoqëria në rolin e qiramarrësit e mat detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë, të cilat nuk janë paguar në atë datë. Pagesat e qirasë skontohen duke përdorur normën e interesit të përcaktuar të qirasë, nëse kjo normë përcaktohet lehtë. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtë, qiramarrësi do të përdorë normën rritëse të huamarrjes së Shoqërisë.

Matja e mëpasshme

Matja e mëpasshme e aktivitetit me të drejtë përdorimi

Pas datës së fillimit, Shoqëria në rolin e qiramarrësit e mat aktivitetin me të drejtë përdorimi duke përdorur modelin e kostos.

Matja e mëpasshme e detyrimit të qirasë

Matja e mëpasshme e detyrimit të qirasë bëhet si më poshtë:

- a) duke rritur vlerën kontabël (neto) për të reflektuar interesin në detyrimin e qirasë;
- b) duke pakësuar vlerën kontabël (neto) për të reflektuar pagesat e qirasë;
- c) duke rimatur vlerën kontabël (neto) për të reflektuar çdo rivlerësim ose modifikim të qirasë.

4.6 Instrumentet financiare

Njohja dhe cregjistrimi

Aktivitetet dhe detyrimet financiare, fillimisht njihen në datën e tregtimit që është data në të cilën shoqëria bëhet pale në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

Aktivitetet financiare cregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktiviteti financiar, ose kur aktivitetet financiare transferohen dhe në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet transferohen. Një detyrim financiar cregjistrohet kur detyrimi i lindur prej tij zbatohet, anulohet ose skadon.

Klasifikimi dhe matja e aktivitetit financiar

Me përjashtim të arkëtueshmeve tregtare, të cilat në përputhje me IFRS 15, që nuk përmbajnë një përbërës të rëndësishëm financiar dhe maten me cmimin e transaksionit, të gjitha aktivitetet e tjera financiare fillimisht njihen me vlerën e drejtë plus kostot të lidhura direkt me transaksionin (nëse ka).

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

4.6 Instrumentet financiarë(vazhdim)

Aktivitet financiarë, të ndryshme nga ato të përcaktuara dhe efektive si instrumenta mbrojtës, klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- a) Me koston e amortizuar,
- b) Me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI) dhe
- c) Me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (FVTPL).

Shoqëria aktualisht ka vetëm aktive financiare të klasifikuara me kosto të amortizuar. Klasifikimi i aktiveve financiare në njohjen fillestare varet nga:

- d) karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të aktivitetit financiar dhe
- e) nga modeli i biznesit të Shoqërisë për menaxhimin e tyre.

Te gjitha të ardhurat dhe shpenzimet që lindin nga aktivitetet financiare njihen në pasqyrën e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse, në zërin Shpenzime/te Ardhura Financiare, me përjashtim të zhvleresimit të llogarive të arketueshme, i cili paraqitet në zërin e Shpenzimeve të tjera.

Aktivitetet financiare me koston e amortizuar

Shoqëria mat aktivitetet financiare me koston e amortizuar nëse plotësohen të dyja kushtet e mëposhtme:

- f) aktivi financiar mbahet brenda një modeli biznesi me qëllim të mbajtjes së mjeteve financiare për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe
- g) kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar të japin rritje në data të përcaktuara flukse monetare që janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar.

Pas njohjes fillestare, ato maten me koston të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe janë subjekt i rënies në vlerë (zhvleresimit). Fitimet dhe humbjet njihen në fitim ose humbje kur aktivi reregjistrohet, modifikohet ose zhvlerësohet. Aktivitetet financiare të Shoqërisë që maten me koston e amortizuar përbëhen kryesisht nga të drejta të arketueshme, aktive financiare, kredi me interes dhe huadhënie, dhe mjete monetare dhe të ngjashme

Zhvleresimi i aktiveve financiare

SNRF 9 kërkon njohjen e humbjeve kreditore të pritshme.

Dhënia e informacioneve shpjeguese të mëtejshme lidhur me zhvlerësimin e aktiveve financiare jepet gjithashtu në shënimet e mëposhtme:

- h) dhënia e informacioneve shpjeguese për supozime të rëndësishme
- i) aktive afatgjata financiare
- j) të arketueshme

Shoqëria njih një zhvlerësim për humbjet e pritshme të kredisë (HPK) për të gjitha instrumentet e borxhit që nuk mbahen me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. HPK bazohen në diferencën midis flukseve monetare kontraktuale që duhet të paguhet në përputhje me kontratën dhe të gjitha flukseve monetare që Shoqëria pret të marrë, duke i zbritur një përaftrim të normës fillestare të interesit efektiv.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

4.6 Instrumentet financiarë (vazhdim)

HPK-të njihen në dy faza. Për ekspozimet ndaj kredive për të cilat nuk ka rritje të ndjeshme në rrezikun e kredisë që nga njohja fillestare, HPK llogaritet për humbjet e kreditit që rezultojnë nga ngjarjet e mospagesave që janë të mundshme brenda 12 muajve të ardhshëm (HPK 12-mujore). Për ato ekspozime kredie për të cilat ka një rritje të ndjeshme në rrezikun e kredisë që nga njohja fillestare, llogaritet një humbje për HPK gjatë gjithë jetës së mbetur të ekspozimit, pavarësisht nga koha e ngjarjes së mospagesës (HPK për të gjithë jetëgjatësinë).

Për të arkëtueshmet tregtare dhe aktivet e kontratës, Shoqëria zbaton një qasje të thjeshtuar në llogaritjen e HPK. Prandaj, Shoqëria nuk ndjek ndryshimet në rrezikun e kredisë, por në vend të kësaj njih një zhvlerësim bazuar në HPK-në për të gjithë jetëgjatësinë e të arkëtueshmes në çdo datë raportimi. Shoqëria ka krijuar një matricë zhvlerësimi që bazohet në përvojën e saj historike të humbjes së kredisë.

Shoqëria konsideron një aktiv financiar në vonese kur pagesat kontraktuale janë 90 ditë të kaluara. Megjithatë, në raste të caktuara, Shoqëria mund të konsiderojë gjithashtu një aktiv financiar si në vonesë kur informacioni brendshëm ose jashtëm tregon se Shoqëria nuk ka gjasa të marrë shumat e papaguara kontraktuale në tërësi. Një aktiv financiar fshihet kur nuk ka pritshmeri të arsyeshme për rikuperimin e flukseve monetare kontraktuale.

Klasifikimi dhe matja e detyrimit financiar

Detyrimet financiare klasifikohen, në njohjen fillestare, si detyrime financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kredite dhe huamarrjet ose të pagueshme.

Të gjitha detyrimet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe, në rastin e huave dhe të pagueshmeve, neto nga kostot e transaksionit të drejtpërdrejtë që i atribuohen.

Detyrimet financiare të Shoqërisë përfshijnë detyrimet tregtare, të tjera të pagueshme dhe detyrime të tjera financiare të cilat janë të gjitha klasifikuar si të mbajtura me kosto të amortizuar.

4.7 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimet për tatim fitimin përfshijnë tatim fitimin aktual dhe tatim fitimin e shtyrë. Shpenzimet për tatim fitimin njihen në fitim ose humbje përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi mbi fitimin aktual është tatimi i pagueshëm mbi të ardhurat e tatueshme duke përdorur normat e taksimit në datën e raportimit dhe çdo rregullim i tatimit të pagueshëm të lidhur me vitin e kaluar. Tatimi mbi fitimin i aplikueshëm është 15% e fitimit të tatueshëm.

Tatimi i shtyrë

Tatim fitimi i shtyrë njihet në lidhje me diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato ndryshojnë, duke u bazuar në ligjet që kanë qenë ose janë në fuqi në datën e raportimit. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet në masën që është e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme do të jenë në dispozicion për të mbuluar diferencat e përkohshme. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe reduktohen në qoftë se përfitimet tatimore nuk do të jenë më të mundshme për tu realizuar.

Tatim fitimi dhe tatimi i shtyrë i vitit njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, përveçse kur lidhen me zëra që njihen në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ose drejtpërdrejtë në kapital, rast në të cilin tatim fitimi dhe tatimi i shtyrë njihen gjithashtu në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ose drejtpërdrejtë në pasqyrën e kapitalit përkatës.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

4.8 Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë paratë në arkë dhe depozitat rrjedhëse në banka apo investime të tjera likuide afatshkurtra me maturitet 3 ose më pak muaj, për të cilat rreziku i një ndryshimi në vlerën e drejtë është i pakonsiderueshëm, investime të cilat shoqëria i përdor për menaxhimin e angazhimeve të saj afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar me koston e tyre të amortizuar.

4.9 Kapitali aksionar dhe dividendët

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar konsiston në mjetet monetare të kontribuara nga themeluesit e shoqërisë. Kapitali aksionar paraqitet me vlerën në Lekë të konvertuar me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Kapitali aksionar i shoqërisë njihet me vlerë nominale. Kapitali aksionar i cili është i nënshkruar për emetim, por që ende nuk është i regjistruar është i paraqitur veçmas në pasqyrën e lëvizjes së kapitalit. Një kontribut i pafinancuar i kapitalit, i cili është i pagueshëm në të ardhmen në një shumë të parapërcaktuar, është klasifikuar si kapital i paregjistruar dhe i papaguar, përveç rasteve kur marrja e kontributit është vlerësuar në mënyrë të arsyeshme.

Dividendët

Shpërndarja e dividendëve për aksionarin e Shoqërisë njihet në pasqyrat financiare të Shoqërisë si detyrim në periudhën në të cilën janë aprovuar nga aksionari i Shoqërisë.

4.10 Përfitimet e punonjësve

Fondet e sigurimeve shoqërore dhe të shëndetit

Sipas legjislacionit shqiptar në fuqi Shoqëria është e detyruar të paguajë kontribute fikse për llogari të punonjësve në një fond të administruar nga qeveria. Të gjitha këto pagesa/detyrime njihen si shpenzim në periudhën të cilës i përkasin.

Përfitimet në përfundim të marrëdhënieve të punës

Përfitimet në përfundim të marrëdhënieve të punës njihen si shpenzim kur Shoqëria është e angazhuar dukshëm, pa mundësi reale tërheqjeje dhe kur Shoqëria njih kosto ristrukturimi. Nëse përfitimet nuk pritët të zgjidhen tërësisht brenda 12 muajve nga data e raportimit, atëherë ato skontojnë.

Plani i Kontributeve të Përcaktuara

Nën planin e kontributeve të përcaktuara, shuma e përfitimeve të ardhshme është përcaktuar nga kontributet e paguara dhe nga interesat e fituara të fondit. Detyrimet janë njohur në fitim apo humbje në periudhën e duhur dhe janë paraqitur interesa të shtuara te fondit të pensionit nga të ardhurat nga investimet.

4.11 Provigjonet

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që flukse dalëse të përfitimeve ekonomike do të përdoren për shlyerjen e detyrimit. Shuma e njohur si provigjon është vlerësimi më i mirë i shumës që kërkohet për të shlyer detyrimin aktual në fund të periudhës raportuese, duke marrë parasysh rreziqet dhe pasiguritë rreth detyrimit. Kur një provigjon matet duke përdorur flukset monetare të vlerësuara për të shlyer detyrimin aktual, vlera kontabël e saj është vlera aktuale e atyre flukseve (kur efekti i vlerës në kohë të parasë është material).

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

4.11 Provigjonet (vazhdim)

Provigjonet e ristrukturimit njihen vetëm nëse ekziston një plan i detajuar formal për ristrukturimin dhe drejtimi ose ka komunikuar karakteristikat kryesore të planit ndaj atyre të prekur ose ka filluar zbatimin. Rezervat nuk njihen për humbjet e ardhshme operationale.

Kur disa ose të gjitha përfitimet ekonomike të kërkuara për të shlyer një provizion priten të mbulohen nga një palë e tretë, një arkëtim njihet si një aktiv, nëse është praktikisht e sigurtë se rimbursimi do të merret dhe shuma e arkëtueshme mund të matet me besueshmëri.

4.12 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato pasqyrohen në shënimet shpjeguese nëse mundësia e daljes së burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e ulët. Aktivitetet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por paraqiten në shënimet shpjeguese kur mundësia e të ardhurave ekonomike është e mundshme. Shuma e një humbje të kushtëzuar njihet si provizion nëse është e mundshme që ngjarje të ardhshme do të konfirmojnë provizionin, një detyrim njihet në datën e Pasqyrës e pozicionit financiar kur një vlerësim i pranueshëm i humbjes mund të bëhet në mënyrë të besueshme.

4.13 Llogaritë e arkëtueshme tregtare

Të arkëtueshmet janë aktive financiare jo derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv letrash me vlerë, përveç atyre që shoqëria kërkon t'i shesë në periudhë afatshkurtër ose janë përcaktuar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Të arkëtueshmet njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe pastaj maten me koston e amortizuar duke përdorur koston efektive të interesit, duke zbritur provizionin për zhvlerësim. Një provizion për zhvlerësim për llogaritë e arkëtueshme krijohet kur ka evidencë objektive që shoqëria nuk do jetë në gjendje të arkëtojë të gjithë shumat në përputhje me kushtet e tyre në momentin fillestar.

4.14 Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç aktiveve tatimore të shtyra, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidencë për zhvlerësim. Nëse ka evidencë të tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Humbja nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aktiviteti ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme të aktivitetit. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare që janë të pavarura nga aktivitetet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave. Vlera e rikuperueshme e një aktiviteti, ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e vlerësuar të ardhshme të mjeteve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivitetin. Humbjet e mëparshme rishikohen në çdo datë raportimi për të vlerësuar nëse ka evidencë se rënia në vlerë është zbutur, ose nuk ekziston më. Një humbje anulohet nëse ka evidencë se nuk ka zhvlerësim dhe ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke zbritur zhvlerësimin apo amortizimin dhe sikur të mos ishte njohur më parë ndonjë humbje nga rënia në vlerë.

4.15 Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen në fitim ose humbje gjatë përdorimit të shërbimit ose në datën në të cilën ato kanë ndodhur. Shpenzimet për garancitë njihen dhe ngarkohen kundrejt provizionit përkatës në momentin që njihet e ardhura e lidhur me to.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

4.16 Të ardhura dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat e fondeve të investuara në depozita bankare dhe fitimet nga kurset e këmbimit. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesave të huamarrjeve dhe humbjet nga kurset e këmbimit. Fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit raportohen bruto. Të ardhurat nga interesat njihen në bazë të të drejtave të konstatuara, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

4.17 Gjykime të rëndësishme kontabël, çmuarjet dhe vlerësimet

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon gjykime dhe vlerësime që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në raportimin e vlerave të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe të shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara nga shoqëria.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe janë bazuar në eksperiencën e mëparëshme dhe faktorë të tjerë, përfshirë edhe pritshmëritë për ngjarjet e ardhëshme, të cilët besohet se janë të përshtatshme dhe relevante për rrethanat aktuale. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën gjatë së cilës vlerësimi është rishikuar nëse rishikimi ndikon vetëm atë periudhë kontabël ose në periudhën gjatë së cilës vlerësimi është rishikuar dhe periudha të ardhëshme nëse rishikimi ndikon të dyja periudhat si aktuale dhe të ardhëshme.

Informacioni mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykimet mbi aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë të paraqitura më poshtë:

Të ardhurat nga kontratat me klientët

Shoqëria do të aplikojë gjykimet e mëposhtëme të cilat ndikojnë në mënyrë të rëndësishme në përcaktimin e shumës dhe kohën e njohjes se të ardhurave nga kontratat me klientët:

a) Identifikimi i detyrimeve të performancës

Shoqëria ka lidhur disa kontrata sipërmarrjeje kryesisht me disa banka te nivelit te dyte në të cilat premtion regjistrimin e anëtarësimeve dhe tregëtimit të titujve në Bursë. Kontratat e sipërmarrjes janë një premtim shitje shërbimi te cilat e përcaktojnë vlerën e saj per cdo anetarsim. Nurmi i tyre mund të identifikohet në mënyrë individuale me një çmim individual. Çmimi i shitjes për cdo anetarsim mund të identifikohet lehtësisht në kontratat e sipërmarrjes. Rrjedhimisht, Shoqëria ka alokuar çmimin e transaksionit për secilin produkt në baza individuale.

b) Përcaktimi i metodës për llogaritjen e konsideratës së ndryshueshme

Duke qënë se disa nga kontratat mund te përmbajnë zbritjet tregëtare dhe të drejta të kthimit të njësisë së blerë Shoqëria duhet ta masi këtë konsiderate të ndryshueshme sipas rezultatit më të mundshëm ose me metodën e vlerës së pritshme bazuar në atë metodë që parashikon më mirë shumën e konsideratës për të cilën do të ketë të drejtë.

c) Përcaktimi i vlerës së drejtë

Shoqëria nuk ka politika të rëndësishme kontabël dhe dhënie informacionesh shpjeguese të miratuara nga vetë Shoqëria, të cilat kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, si për aktivet dhe detyrimet financiare dhe jofinanciare. Vlerat e drejta janë përcaktuar për qëllime të matjes dhe prezantimit. Aty ku është e aplikueshme, informacionet e mëtejshme në lidhje me supozimet e bëra në përcaktimin e vlerave të drejta janë shpalosur në shënimet specifike për atë aktivet ose detyrimet.

Drejtimi i Shoqërisë vlerëson që vlera e drejtë e parasë, llogarive të arkëtueshme, llogarive të pagueshme, aktiveve të tjera afatshkurtra dhe detyrimeve të tjera afatshkurtra dhe detyrimet per tatim fitimin, përafrohet me vlerën kontabel kryesisht për shkak të maturitetit afatshkurtër të këtyre instrumentave.

5. GJYKIME TË RËNDËSISHME KONTABËL, ÇMUARJET DHE VLERËSIMET

Parimi i vijimesisë

Shoqëria është ende në fazat fillestare të biznesit dhe që nga krijimi i saj ka pësuar humbje financiare dhe nuk ka gjenuar të ardhura. Kjo dhe si pasojë e skontove të plota të dhëna gjatë vitit 2018 dhe vitit 2019 ndaj klientëve të saj (anëtarët që janë banka dhe/ose firma brokerimi) me qëllimin e gjallërimit të tregëtimit në këtë platformë të re .

Shoqëria vazhdon të ketë një situatë të kënaqshme likuiditeti ku aktivet afatshkurtra i tejkalojnë detyrimet afatshkurtra me rreth 2 herë dhe në përgjithësi nuk është e financuar me borxhe nga palë të treta.

Asambleja e përgjithshme, me vendimin nr.21 te dates 14 gusht 2019, vendosi të rrisë kapitalin e nënshkruar të Shoqërisë. Shoqëria, bazohet kryesisht në mbështetjen e aksionerëve të saj, të cilët kanë qëllimin dhe aftësinë për të mbështetur financiarisht Shoqërinë, për një periudhë kohore të pakten për 12 muajt e ardhshëm. Aksionerët kryesorë të shoqërisë ka konfirmuar mbështetjen e plote për një periudhë kohore të pakten për 12 muajt e ardhshëm.

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.62/2020, "Për Tregjet e Kapitalit" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ALSE mori të gjitha masat për të siguruar përshtatjen e aktivitetit të saj me kërkesat e reja ligjore. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me Vendimin e Bordit nr.90, datë 28.04.2022, miratoi përshtatshmërinë e shoqërisë për ushtrimin e veprimtarisë së bursës në përputhje me kërkesat e Ligjit 62/2020 "Për Tregjet e Kapitalit" si dhe e pajisi Bursen Shqiptare të Titujve me Licencën e re të aktivitetit.

Shoqëria ka vlerësuar aftësinë e saj për të vijuar aktivitetin në mënyrë të pandërprerë. Në këtë kuadër, duhet të theksohet se në janar 2025, Bursa ka nënshkruar një kontratë për ofrimin e trajnimeve për Banka Credins, me një vlerë prej 3 milionë Lekë. Këto fonde, tashmë të arkëtuara, do të mbulojnë shpenzimet e operimit gjatë vitit 2025, duke forcuar më tej kapacitetin financiar të shoqërisë për të vijuar aktivitetin e saj.

Tatimi mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Është i nevojshëm gjykimi për përcaktimin e shumës së tatimit mbi fitimin aktual dhe atyre të shtyra. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar tatimor është i pasigurt. Shoqëria njeht detyrimin ne rast te auditimit të pritur tatimor bazuar në vlerësimet se taksa shtesë do mund te lindin si detyrim. Nese tatimi përfundimtar do jete i ndryshëm nga shumat që ishin regjistruar fillimisht, diferencat do e ndikojë në vlerën aktuale te aktiveve tatimore të shtyra dhe pasiveve në periudhën në të cilën një përcaktim i tillë është bërë.

Rishikimi i zhvlerësimit

Rikuperimi i aktiveve është një çështje që kërkon gjykim të Drejtimit, që kërkon vlerësim nëse vlera kontabël e aktiveve mund të mbështetet në vlerën neto aktuale të flukseve monetare të ardhshme që pritet të gjenerohen nga përdorimi i aktiveve të tilla duke përdorur parashikimet e flukseve monetare të cilat janë skontuar me një normë të përshtatshme. Në llogaritjen e vlerës aktuale neto të flukseve monetare të ardhshme, janë të nevojshme supozime në lidhje me çështjet e pasigurta, siç përmendet më poshtë.

Standardet SNRF kërkojnë që Drejtimi të kryejë teste vjetore për zhvlerësimin e aktiveve dhe përcaktimin e jetës së tyre, gjithashtu kërkohet dhe vlerësimi i situatave të mundshme që do të sillnin mosrikuperimin e vlerës së aktiveve. Shoqëria ka arritur në përfundimin se nuk ka indikacione për zhvlerësim të aktiveve në 31 Dhjetor 2025.

5. GJYKIME TË RËNDËSISHME KONTABËL, ÇMUARJET DHE VLERËSIMET(VAZHDIM)

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Për të identifikuar një humbje nga përkeqësimi i aktiveve financiare, Shoqëria konsideron një gamë më të gjerë informacioni gjatë vlerësimit të rrezikut të kredisë dhe matjen e humbjeve të pritshme të kreditit, duke përfshirë ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale, parashikimet e arsyeshme dhe të mbështetura që ndikojnë në arkëtueshmërinë e pritshme të flukseve monetare të ardhshme të instrumentit.

Në zbatimin e kësaj qasjeje të ardhshme, bëhet një dallim midis:

a) instrumentet financiare që nuk janë përkeqësuar dukshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare ose që kanë rrezik të ulët të kredisë ('Faza 1') dhe

b) instrumentet financiare që janë përkeqësuar dukshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare dhe rreziku i kredisë i të cilit nuk është i ulët ('Faza 2').

c)'Faza 3' do të mbulonte aktivet financiare që kanë tregues objektive të zhvlerësimit në datën e raportimit.

Humbjet e pritshme të kreditit '12 - mujore' njihen për kategorinë e parë, ndërsa 'humbjet e pritshme të kreditit përgjatë jetës së instrumentit' njihen për kategorinë e dytë.

Matja e humbjeve të pritshme të kredisë përcaktohet nga një vlerësim i ponderuar me probabilitetin e humbjeve të kredisë gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar.

Shoqëria nuk ka identifikuar dhe njohur zhvlerësim për aktivet financiare me 31 Dhjetor 2025.

6. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

6.1 Administrimi i rrezikut financiar

Aktivitetet e shoqërisë e ekspozojnë atë ndaj një shumëllojshmërie rreziqesh financiare që përfshijnë rrezikun e kreditit dhe rrezikun e lidhur me efektet e ndryshimit në kursin e këmbimit të monedhave të huaja dhe normat e interesit. Manaxhimi i rrezikut të shoqërisë fokusohet në paparashikueshmërinë e tregjeve dhe synon të minimizojë efektet potenciale të kundërta mbi performancën e biznesit të Shoqërisë.

6.2 Rreziku i kredisë

Rreziku i kreditit është rreziku i humbjes financiare për shoqërinë nëse klientët ose palët e tjera nuk përmbushin detyrimet kontraktuale dhe lind kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të shoqërisë. Ekspozimi i shoqërisë ndaj rrezikut të kreditit është kryesisht i influencuar nga karakteristikat individuale të çdo klienti. Shoqëria krijon një fond provizioni për zhvlerësim i cili përfaqëson vlerësimet e shoqërisë për humbjet e ndodhura në lidhje me llogaritë e arkëtueshme bazuar tërësisht në humbjet specifike të lidhura me ekspozime individualisht të rëndësishme.

Shoqëria nuk ka ekspozim të rëndësishëm ndaj rrezikut të kreditit që mund të ndikojë në performancën financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2025. Ekspozimi maksimal i shoqërisë ndaj rrezikut të kreditit është përfaqësuar nga vlerat kontabël të çdo aktivi financiar në pasqyrën e pozicionit financiar të përmbledhura si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Pa vonesa dhe të pazhvlerësuar		
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	78,495	83,256
Llogarite e arkëtueshme tregtare dhe te tjera	198,467	307,464
Totali i Aktiveve	276,962	390,720

Bursa Shqiptar e Titujve ALSE sh.a.

Shënime të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat janë të shprehura në lekë përveçse kur përcaktohet ndryshe)

6. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR(VAZHDIM)

6.3 Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku i humbjes si pasojë e ndryshimit të çmimeve, kursit të këmbimit dhe normës së interesit në treg. Niveli i rrezikut të tregut ndaj të cilit shoqëria është e ekspozuar në një moment të caktuar varet nga kushtet në të cilat ndodhet tregu, pritshmëritë për çmimet në të ardhmen ose lëvizjet në normat e interesit të tregut, përbërja e aktiveve materiale të shoqërisë dhe kontratat në të cilat Shoqëria është përfshirë.

a) Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria operon dhe është e ekspozuar ndaj kursit të këmbimit me valutat e huaja, veçanërisht me monedhën Euro. Rreziku i kursit të këmbimit vjen kur ka njohje të transaksioneve tregtare si aktive ose detyrime në një monedhë e cila është e ndryshme nga monedha funksionale e Shoqërisë. Shoqëria nuk e diversifikon ekspozimin ndaj këtij lloji rreziku sepse nuk pret humbje të konsiderueshme si pasojë e luhatjeve të kursit të këmbimit me monedhat e huaja krahasuar me kursin në datën e raportimit.

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj kursit të këmbimit më 31 Dhjetor 2025 ka qenë si më poshtë:

2025	Vlera Kontabel Neto	EURO	USD	LEK
Aktivet				
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	78,495	6,077	-	72,419
Llogarite e arketueshme tregtare dhe te tjera	198,467	-	-	198,467
Totali i Aktiveve	276,962	6,077	-	270,886
Detyrimet				
Llogarite e pagueshme tregtare dhe te tjera	213,999	45,676	-	168,323
Detyrimi afatshkurter	-	-	-	-
Totali i detyrimeve	213,999	45,676	-	168,323
Hendeku i Likuiditetit	62,963	(39,599)	-	102,563

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj kursit të këmbimit më 31 Dhjetor 2024 ka qenë si më poshtë:

2024	Vlera Kontabel Neto	EURO	USD	LEK
Aktivet				
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	83,256	4,818	-	78,438
Llogarite e arketueshme tregtare dhe te tjera	307,464	-	-	307,464
Totali i Aktiveve	390,720	4,818	-	385,902
Detyrimet				
Llogarite e pagueshme tregtare dhe te tjera	337,090	46,328	-	290,762
Detyrimi afatshkurter	-	-	-	-
Totali i detyrimeve	337,090	46,328	-	290,762
Hendeku i Likuiditetit	53,630	(41,510)	-	95,140

6. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR(VAZHDIM)

6.3 Rreziku i tregut (vazhdim)

a)Rreziku i kursit të këmbimit(vazhdim)

Analiza e ndjeshmërisë për monedhat e huaja

Analiza e ndjeshmërisë më poshtë është përcaktuar në bazë të ekspozimit ndaj monedhës së huaj në datën e raportimit dhe të përcaktuar ndryshimit duke u zhvilluar në fillim të vitit financiar dhe të mbajtur konstante gjatë periudhës raportuese.

Në vijim paraqiten efektet e ndryshimeve në kursin e këmbimit në humbjen neto, duke konsideruar të gjitha variablat e tjera të mbahen konstante:

			2025
EUR	Shuma neto	10%	-10%
	(39,599)	(3,960)	3,960
			2024
EUR	Shuma neto	10%	-10%
	(41,510)	(4,151)	4,151

Analiza e ndjeshmërisë përfshin vetëm zërat monetare të shprehura në monedhë të huaj në fund të vitit, dhe një korrelacion të vlerave të tyre për një 10% ndryshim në kurset e këmbimit. Përqindja është përcaktuar duke u bazuar në paqëndrueshmërinë e tregut në kursin e këmbimit në 12 muajt e mëparshëm. Vlerat pozitive/negative tregojnë një rritje/ulje të fitimit ose kapitalit, e cila ndodh kur Leku forcohet/dobësohet ndaj një monedhe të huaj me +/- 10%.

b)Rreziku i çmimit

Shoqëria nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të çmimit të kapitalit sepse nuk zotëron aktive financiare në përbërjen e instrumenteve të kapitalit në datën e raportimit. Nuk është politikë e shoqërisë të blejë këto lloj instrumentesh dhe të ekspozohet ndaj rrezikut të çmimit që lidhet me lëvizjet e indekseve të tregut të kapitalit.

c)Rreziku i normës së interesit

Të gjithë aktivet e shoqërisë të cilat mbartin interesa lidhen me llogaritë në banka. Të ardhurat e shoqërisë dhe flukset e parave nga aktiviteti operacional nuk janë të ekspozuar në masë të konsiderueshme ndaj ndryshimeve në normat e interesit të tregut.

Bursa Shqiptar e Titujve ALSE sh.a.

Shënime të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat janë të shprehura në lekë përveçse kur përcaktohet ndryshe)

6. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR(VAZHDIM)

6.4 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit përcaktohet si rreziku që një njësi ekonomike do të përballet me vështirësi për të përmbushur detyrimet që lidhen me pasivet financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj nevojave të përditshme për burime monetare, kryesisht për të shlyer detyrimet e krijuara gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj normal. Drejtimi monitoron çdo ditë, javë dhe muaj duke bërë parashikime për flukset e parave.

Tabelat më poshtë analizojnë detyrimet financiare sipas maturimit duke u bazuar në periudhën e mbetur nga data e raportimit deri në datën e maturimit sipas kontratës. Shumat e paraqitura në tabelën më poshtë janë flukset e parave të pa skontuara sipas kontratës. Balancat deri në 12 muaj barazohen me vlerën e tyre kontabël sepse ndryshimi me vlerën e skontuar nuk është i konsiderueshëm.

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit me 31 Dhjetor 2025 paraqitet si më poshtë:

2025	Vlera Kontabel Neto	6 muaj ose me pak	6-12 muaj	1-5 vite
Aktivet				
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	78,495	78,495	-	-
Llogarite e arketueshme tregtare dhe te tjera	198,467	198,467	-	-
Totali i Aktiveve	276,962	276,962	-	-
Detyrimet				
Llogarite e pagueshme tregtare dhe te tjera	213,999	213,999	-	-
Detyrime afatgjata për t'u paguar	-	-	-	-
Totali i detyrimeve	213,999	213,999	-	-
Hendeku i Likuiditetit	62,963	62,963	-	-

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit me 31 Dhjetor 2024 paraqitet si më poshtë:

2024	Vlera Kontabel Neto	6 muaj ose me pak	6-12 muaj	1-5 vite
Aktivitet				
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	83,256	83,256	-	-
Llogarite e arketueshme tregtare dhe te tjera	307,464	307,464	-	-
Totali i Aktiveve	390,720	390,720	-	-
Detyrimet				
Llogarite e pagueshme tregtare dhe te tjera	337,090	337,090	-	-
Detyrime afatgjata për t'u paguar	-	-	-	-
Totali i detyrimeve	337,090	337,090	-	-
Hendeku i Likuiditetit	53,630	53,630	-	-

Bursa Shqiptar e Titujve ALSE sh.a.**Shënime të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025***(Të gjitha shumat janë të shprehura në lekë përveçse kur përcaktohet ndryshe)***7. Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre**

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre më 31 Dhjetor 2025 dhe 31 Dhjetor 2024 përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2025</u>	<u>31 dhjetor 2024</u>
Mjete Monetare në arkë		
Arka ALL	985	985
Arka EUR	75	77
Total	<u>1,061</u>	<u>1,062</u>
Mjete Monetare në banka		
Bank ALL	71,433	77,453
Bank EUR	6,001	4,741
Total	<u>77,434</u>	<u>82,194</u>
Total	<u>78,495</u>	<u>83,256</u>

8. Llogari te arketueshme dhe te tjera

Kërkesa të tjera të arketueshme më 31 Dhjetor 2025 dhe 31 Dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2025</u>	<u>31 dhjetor 2024</u>
Kerkesa te arketueshme nga kliente	178,500	285,686
Tatimi ne Burim	-	1,811
Total	<u>178,500</u>	<u>287,497</u>

9. Parapagime dhe shpenzimet e shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 Dhjetor 2025 dhe 31 Dhjetor 2024 përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2025</u>	<u>31 dhjetor 2024</u>
Parapagime te tjera	19,967	19,967
Total	<u>19,967</u>	<u>19,967</u>

Bursa Shqiptar e Titujve ALSE sh.a.

Shënime të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumatat janë të shprehura në lekë përveçse kur përcaktohet ndryshe)

10. Aktivet afatgjata materiale

Aktivitet afatgjata materiale më 31 Dhjetor 2025 dhe 31 Dhjetor 2024 përbëhen si më poshtë:

Kosto Historike	E drejta e perdorimit te		Rikonstrukcion	Orendi dhe	Kompjuterat dhe	Total
	aktiveve te marra me qera	Ndertesa				
Më 31 dhjetor 2024	-	-	-	1,814,527	2,205,835	4,020,362
Pakësime	-	-	-	-	-	-
Shtesa	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2025	-	-	-	1,814,527	2,205,835	4,020,362
Amortizimi	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2024	-	-	-	1,486,263	1,945,056	3,431,319
Pakësime	-	-	-	-	-	-
Shtesa	-	-	-	82,068	86,928	168,996
Më 31 dhjetor 2025	-	-	-	1,568,331	2,031,984	3,600,315
Vlera kontabël e mbetur	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2024	-	-	-	328,264	260,779	589,043
Më 31 dhjetor 2025	-	-	-	246,196	173,851	420,047

Bursa Shqiptar e Titujve ALSE sh.a.

Shënime të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat janë të shprehura në lekë përveçse kur përcaktohet ndryshe)

11. Aktivet afatgjata jo-materiale

Aktivët afatgjata jomateriale më 31 Dhjetor 2025 dhe 31 Dhjetor 2024 përbëhen si më poshtë:

	Programe kompjuterike	Total
Kosto Historike		
Më 1 janar 2024		
Shtesa	12,369,445	12,369,445
Më 31 dhjetor 2024	-	-
Shtesa	12,369,445	12,369,445
Më 31 dhjetor 2025	12,369,445	12,369,445
Amortizimi		
Më 1 janar 2024		
Shtesa	7,425,140	7,425,140
Më 31 dhjetor 2024	1,232,892	1,232,892
Shtesa	8,658,032	8,658,032
Më 31 dhjetor 2025	1,213,764	1,213,764
	9,871,796	9,871,796
Vlera kontabël e mbetur		
Më 31 dhjetor 2024	3,711,413	3,711,413
Më 31 dhjetor 2025	2,497,649	2,497,649

Aktivët afatgjata jomateriale përbëhen nga Liçensa e programit "Quick Trade" i cili ka filluar të përdoret për kuotimin e titujve që nga muaji Mars 2018 e në vijim.

12. Llogari të pagueshme dhe te tjera te pagueshme

Llogari të pagueshme më 31 Dhjetor 2025 dhe 31 Dhjetor 2024 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Tatim mbi vlerën e shtuar (DPT)	93,089	50,044
Te pagueshme ndaj Furnitoreve	72,887	78,853
Sigurime shoqerore dhe shendetesore	28,898	32,749
Tatim ne burim	19,125	-
Te pagueshme ndaj te treteve	-	75,084
Te pagueshme ndaj punonjesve	-	100,360
Total	213,999	337,089

Bursa Shqiptar e Titujve ALSE sh.a.

Shënime të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat janë të shprehura në lekë përveçse kur përcaktohet ndryshe)

13. Të ardhura të shtyra

Të ardhura të shtyra më 31 Dhjetor 2025 dhe 31 Dhjetor 2024 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Te ardhura te shtyra	-	-
Totali	-	-

14. Detyrim per qera financiare

Detyrimet nga kontratat e qiramarrjes financiare më 31 Dhjetor 2025 dhe 31 Dhjetor 2024 sipas maturitetit paraqiten si me poshte:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Detyrimi afatshkurter IFRS 16	-	-
Detyrimi afatgjate IFRS 16	-	-
Totali	-	-

15. Detyrimi për tatimin e shtyrë

Detyrimi për tatimin e shtyrë më 31 Dhjetor 2025 dhe 31 Dhjetor 2024 është përlogaritur si në vijim:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Vlera kontabel e aktiveve afatgjate jo-materiale	2,497,644	3,711,413
Vlera tatimore	1,018,227	1,527,340
Diference	1,479,417	2,184,073
% e tatimit	15%	15%
Detyrimi tatimor i shtyre	221,913	327,611

16. Kapitali

Më 31 Dhjetor 2025, kapitali aksionar i regjistruar është 85,000,000 Lekë (2024: 85,000,000 Lekë), dhe përbëhet nga 850.000 aksione me vlerë nominale 100 Lekë. Struktura aksionare bazuar në kapitalin e paguar terësisht dhe të regjistruar më 31 Dhjetor 2025 dhe 31 Dhjetor 2024 është si vijon:

	31 dhjetor 2025			31 dhjetor 2024		
	Në %	Numër aksionesh	Në Lek	Në %	Numër aksionesh	Në Lek
Banka Credins	45.59	387,500	38,751,500	45.59	387,500	38,751,500
Banka Amerikane e Investimeve	45.59	387,500	38,751,500	45.59	387,500	38,751,500
AK-Invest	8.82	75,000	7,497,000	8.82	75,000	7,497,000
Totali	100	850,000	85,000,000	100	850,000	85,000,000

Bursa Shqiptar e Titujve ALSE sh.a.

Shënime të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat janë të shprehura në lekë përveçse kur përcaktohet ndryshe)

17. Të ardhura nga aktiviteti

Të ardhurat nga aktiviteti konsistojnë vetëm në të ardhurën nga shërbimi i regjistrimit të anëtarësimeve dhe tregëtimit të titujve në Bursë. Të ardhurat nga aktiviteti për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2025 dhe 31 Dhjetor 2024 përbëhen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
Të ardhura të tjera	2,509,974	3,511,084
Te ardhura nga aktiviteti	2,364,819	2,880,083
Total	4,874,793	6,391,167

Te ardhura të tjera përfshijnë të ardhura nga nënshkrimi i "Kontratë Shërbimi" me Banka Credin sha me objekt ofrimin e trajnimeve me tematike "Instrumentat Financiarë, Tregu i Kapitaleve dhe Procesi i Investimit" si dhe shpërndarja e shpenzimeve të përbashkëta me "Regjistri Shqiptar i Titujve ALREG". Bazuar në kërkesat e SNRF 15 në vijim po paraqesim ndarjen e të ardhurave për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024 sipas natyrës:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
Të ardhura nga komisionet dhe tarifat	871,625	1,671,201
Minus: zbritje për të ardhura nga komisionet dhe tarifat		-
Te ardhura nga komisionet dhe tarifat, neto	871,625	1,671,201
Të ardhura nga anëtarësimet	1,155,000	1,208,882
Minus: zbritje për të ardhura nga anëtarësimet		-
Te ardhura nga anëtarësimet, neto	1,155,000	1,208,882
Te ardhura nga aktiviteti Neto		
Të ardhura nga shpërndarja e shpenzimeve të përbashkëta	9,974	11,084
Të ardhura nga shërmime sipas kontratës me Banka Credins	2,838,194	3,500,000
Te ardhura nga nenqeraja		-
Te ardhura te tjera	2,848,168	11,084
Totali	4,874,793	6,391,167

Bursa Shqiptar e Titujve ALSE sh.a.

Shënime të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat janë të shprehura në lekë përveçse kur përcaktohet ndryshe)

18. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2025 dhe 31 Dhjetor 2024 përbëhen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
Pagat e personelit	960,000	2,313,482
Shpenzimet per sigurime shoqerore dhe shendetesore	163,040	378,854
Kontribute per kontratat e planit vullnetar pens.	24,000	24,000
Shpenzime per sigurim privat jete dhe shendeti	-	44,759
Total	1,147,040	2,761,095

19. Shpenzime administrative

Shpenzimet administrative për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2025 dhe 31 Dhjetor 2024 përbëhen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
Sherbime zhvillimi, testimi dhe implementimi "Quick Trade"	1,467,838	1,513,188
Shpenzime IT	561,284	575,165
Shpenzime per pjesemarrje ne Keshilla Drejtues	423,531	359,829
Shebime konsulence fiskale dhe kontabel	244,957	251,187
Shpenzime taksa e reklames	243,000	243,000
Shpenzime qeraje	262,252	270,450
Shpenzime pershtatje programi BOA dhe ALSE	100,000	100,000
Sherbime auditimi	98,990	102,740
Shpenzime regjistrimi, licensimi, tarifa te tjera	84,288	36,982
Shpenzime tarifa e pastrimit	57,500	57,500
Shpenzime telefoni fiks	19,948	18,000
Shpenzime te tjera	19,640	53,083
Shpenzime tarifa e perkohshme infrast. arsimore	17,000	17,000
Shebime konsulence te tjera	17,060	-
Shpenzime per njoftime gazeta	12,000	10,309
Shpenzime perkthime, redaktime	10,000	11,000
Sherbime ligjore (noteriale)	7,000	7,500
Total	3,646,287	3,626,933

Bursa Shqiptar e Titujve ALSE sh.a.

Shënime të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat janë të shprehura në lekë përveçse kur përcaktohet ndryshe)

20. Shpenzime financiare, neto

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2025 dhe 31 Dhjetor 2024 përbëhen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
Te ardhura financiare	-	-
Te ardhura nga interesi	-	-
Shpenzime interesi dhe komisioni	61,873	74,439
Shpenzime Interesi IFRS 16	-	-
Komisione bankare	61,873	74,439
Shpenzime financiare, neto	(61,873)	(74,439)

21. Fitimi nga kursi i këmbimit

Fitimi nga kursi i këmbimit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2025 dhe 31 Dhjetor 2024 përbëhen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
Fitime nga kursi i këmbimit	141	1,436
Humbje nga kursi i këmbimit	(10,400)	(12,896)
Fitim nga kursi i këmbimit	(10,260)	(11,460)

22. Shpenzime për tatimin mbi fitimin

Në përputhje me ligjet tatimore shqiptare, norma e aplikueshme për tatimin mbi fitimin për vitin 2025 është 15% (2024; 15%). Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruar për qëllime tatimore konsiderohen vetëdeklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore. Shpenzimet e palejuara për efekte tatimore paraqesin shpenzime të pambështetura me dokumentacionin përkatës apo shpenzime të konsideruara të panjohura për efekte fiskale.

Shoqëria për vitin 2025 dhe 2024 nuk njihet aktiv tatimor të shtyrë deri më 31 Dhjetor 2025 përse i takon humbjeve për efekt fiskal, sepse drejtimi gjykon se fitimet e pritshme tatimore të Shoqërisë nuk janë të sigurta sa të përdoren për kompesimin e humbjeve tatimore të mbartura.

Bursa Shqiptar e Titujve ALSE sh.a.

Shënime të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat janë të shprehura në lekë përveçse kur përcaktohet ndryshe)

22. Shpenzime për tatimin mbi fitimin (vazhdim)

Rakordimi i normës efektive të tatimit / i rezultatit kontabël me rezultatin fiskal:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024</u>
Humbja para tatimit		
Të ardhura të patatueshme	(1,373,428)	(1,537,832)
Të ardhura nga dhurimet	-	-
Shpenzime të pazbritshme	-	-
Gjoha dhe penalitete	9,650	8,123
Shpenzime pritje-përcjellje	-	-
Shpenzime utilitare	-	-
Shpenzime të tjera	-	17,170
Totali	(1,363,778)	(1,512,539)
Rezultati tatimor për periudhën	(1,363,778)	(1,512,539)
Tatimi i llogaritur për rezultatin tatimor të periudhës (15%)	-	-
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	-	-

Sipas ligjit të tatimit mbi fitimit Shoqëria mund të mbarte humbjet tatimore në tri periudhat e ardhshme tatimore, sipas parimit "humbja e parë më përpara se ajo e fundit". Në rast se gjatë një periudhe tatimore pronësia e drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë e kapitalit themeltar ose e të drejtave të votës, të një personi, ndryshon me më shumë se 50 për qind, në vlerë ose në numër, paragrafi i mësipërm nuk zbatohet për humbjet e pësuar nga ai person juridik në atë periudhë tatimore dhe në periudhat paraardhëse të tatimit".

Bursa Shqiptar e Titujve ALSE sh.a.**Shënime të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025***(Të gjitha shumat janë të shprehura në lekë përveçse kur përcaktohet ndryshe)***23. Palët e lidhura**

Palët konsiderohen të lidhura nëse njëra palë ka mundësinë të kontrollojë palën tjetër ose të ushtrojë influencë të rëndësishme mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare apo vendimeve të tjera. Palët e lidhura përfshijnë aksionarët, drejtorët dhe entitete të lidhura me shoqërinë. Volumi i këtyre transaksioneve dhe balancat në fund të periudhave respektive janë si vijojnë:

	<u>31 dhjetor 2025</u>	<u>31 dhjetor 2024</u>
<i>Aktive</i>		
Llogari rrjedhëse (Banka Credins)	77,434	82,194
Te arketueshme nga Credins Bank	90,571	160,459
Te arketueshme nga ABI Bank	63,570	68,986
Totali i aktiveve	<u>231,575</u>	<u>311,639</u>
<i>Detyrime</i>		
Te pagueshme tek Credins Bank	-	-
Te pagueshme tek ABI Bank	-	-
Totali i detyrimeve	<u>-</u>	<u>-</u>
	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024</u>
<i>Të ardhura</i>		
Te ardhura nga anetaresimet, komisionet, qiraja	1,885,058	2,511,202
Shërbime të tjera	2,500,000	3,500,000
Te ardhura nga ALREG	9,974	11,083
Totali i të ardhurave	<u>4,395,032</u>	<u>6,022,285</u>

24. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara*Çështje ligjore*

Gjatë aktivitetit të zakonshëm, shoqëria mund të përfshihet në dëme dhe çështje ligjore. Në gjykimin e drejtimit, nga dispozitat e fundit për këto çështje, shoqëria nuk do të ketë ngjarje me peshë të konsiderueshme për të ndikuar në pozicionin financiar të saj ose për të ndryshuar vlerën neto të aktiveve, përveç atyre për të cilat është njohur një provizion në pasqyrat financiare.

Detyrime të kushtëzuara

Shoqëria nuk ka detyrime të kushtëzuara të rëndësishme të kontraktuara deri në datën e pasqyrës së pozicionit financiar të cilat nuk janë njohur në pasqyrat financiare.

25. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka pasur asnjë ngjarje tjetër pas datës së raportimit, e cila kërkon ndonjë paraqitje apo rregullim në pasqyrat financiare.